

**STAR ENGINEERING sh.p.k**

NIPT. L01808028R  
Rruga "Fortuzi" Pll.50 Ap.4 Tirana-ALBANIA  
E-mail: star\_engineering@outlook.com  
+355 (0) 42 23 43 39

---

# **RAPORTI TEKNIK**

## **REHABILITIMI DHE INSTALIMI I SISTEMIT TË NGROHJES I SHKOLLËS 9-VJEÇARE “PREKE GJONI ” BAJZE-KASTRAT**

**JANAR 2016**

## INFORMACION I PERGJITHSHEM

### - Hyrje

Bashkia Malësi e Madhe, kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studim projektimin) për objektin: "Rehabilitimi dhe Instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollës 9-vjeçare "Prek Gjoni", Njësia Kastrat me vlerë paraprake të zërit Ndërtim - Montim 21,204,094 lekë (pa TVSH).

Realizimi i këtij Projekti, ka si qëllim prioritar dhe final, permiresimin e kushteve te mesimdhenies ne shkollen "Prek Gjoni".

### - Vendodhja e objektit

Shkolla 9 – vjeçare "Prek Gjoni" ndodhet ne qendër të qytezës së Bajzës, në anën lindore të aksit rrugor kryesor që përshkon zonën urbane.

Kjo shkolle eshte pjese e Njesise administrative Kastrat e cila ka nje popullsi prej afro 7200 banoresh.



## - **Përshkrim i Përgjithshëm**

Shkolla është ndërtuar në vitin 1980 godina e saj është një ndërtesë 45 vjeçare dhe ndër vite janë kryer rehabilitime të pjesshme të godinës si dhe një është ndërtuar një shtesë anësore ku janë pozicionuar nyjet sanitare. Godina e shkollës është 3 kat dhe mbulesa është me çati. Sipërfaqja totale e territorit është rreth 5000 m<sup>2</sup>, kurse sip.ndërtimit 672 m<sup>2</sup> (kati përdhe).

## - **Përshkrimi i gjendjes aktuale të objektit**

Grupi i projektimit, pasi u njoh fillimisht me Detyren e Projektimit, inspektoi objektin për të verifikuar gjendjen faktike, si dhe për të evidentuar problemet specifike që kërkojnë nderhyrje. Në këtë kuader Grupi i Projektimit zhvilloi dhe takime me Drejtuesit e Shkolles si dhe me personelin arsimor, nga të cilët u njoh edhe me anën funksionale të ambjentëve të shkolles.

- Nga inspektimi i Shkolles u evidentuan këto probleme:

- Shkolla nuk ka palestër mësimi i edukimit fizik në periudhën e dimrit nuk zhvillohet
- Dyert janë druri dhe në pjesën më të madhe janë të dëmtuara, të çara, pa doreza etj.
- Nyjet sanitare janë të amortizuara jashtë kushteve higjieno-sanitare
- Dyshemeja në disa klasa është e pa shtruar me pllaka
- Catia ka pesuar ulje në pjesën qendrore;
- Ka një plasaritje në vendin ku bashkohet godina ekzistuese e shkollës me shtesën e nyjeve sanitare;
- Ka problem me furnizimin me ujë
- Mungon sistemi qendror i ngrohjes, nuk ka asnjë mjet të mbrojtjes nga zjarri
- Nevojitet ndërtimi me shtresat përkatëse, sistemimi i terreneve sportive, instalimi i rrjetave dhe paisjeve të pershtashme sportive në oborrin e pasëm të shkollës.
- Oborri ka pemë të larta, por nuk është i sistemuar; muri rrethues është i dëmtuar dhe mungojnë stolat, lodrat për parashkolloret si dhe gjelbërimi i ulët.

Shkolla 9-vjeçare "Prek Gjoni" propozohet për rikonstrukcion të godinës ekzistuese, instalimin e ngrohjes, rikonstrukcion i çatisë, rikonstrukcion i plotë i nyjeve sanitare, ndertimin e terreneve sportive , riorganizimin dhe gjelbërim e ambientit të jashtëm.


### **Pamje te gjendjes ekzistuese te Shkolles**

#### *Pamje te Fasades*



#### *Pamje nga brenda e Shkolles*






*Pamje te Oborrit dhe Terreneve sportive*



**PUNIMET QE DO TE REALIZOHEN**





*Projekt - Zbatimi i shkolles "Prek Gjoni" eshte mbi bazen e Detyres se Projektimit te hartuar nga Bashkia Malesi e Madhe , ispektimit ne vend si dhe takimeve me drejtues te Shkolles.*

***Ne Projekt Zbatim jane pasqyruar te gjitha ndrerhyrjet te nevojshme per permiresimin e kushteve te mesimdhenies ne kete shkolle, ne perputhje me kerkesat e standarteve.***

*Projekti Zbatimi eshte shoqeruar me Raportin Teknik, Specifikimet Teknike dhe Preventivin e Punimeve te hartuar me cmimet e VKM se vitit 2015.*

### **Pershkrimi i nderhyrjes per rikonstruksionin**

Shkolla "Prek Gjoni" eshte nje godine 3KT e pozicionuar ne pjesen lindore te aksit rrugor kryesor qe kakolon ne zonën urbane të Bajzës. Shkolla është ne pergjithesi paraqitet me disa probleme qe vijne pjeserisht nga mungesa e investimit fillestar dhe pjeserisht nga mirembajtja jo e vazhduar.

Grupi i projektimit, pasi u njoh fillimisht me detyren e Projektimit, inspektoi objektin per te verifikuar gjendjen faktike, si dhe per te evidentuar problemet specifike qe kerkojne nderhyrje. Ne kete kuader Grupi i Projektimit zhvilloi dhe takime me Drejtuesit e Shkolles si dhe me personelin arsimor, nga te cilet u njoh edhe me anen funksionale te ambjenteve te shkolles.


Nga Grupi i Projektimit u planifikuan keto nderhyrje për përmirësimin e planimetrisë së shkollës në funksion të plotësimit të standarteve të kërkuara:

Në katin perdhe njëri prej ambienteve do te përshtatet per sallë polifunksionale sipas kerkess se stafit drejtues të shkollës, dhe klasa e fundit në anën e majtë të korridorit , do të përshtatet per sallë fiskulture. Në kat është parashikuar edhe ambienti teknik në të cilin do te instalohet kaldaja.

Në katin e parë, janë parashikuar dhoma e mjekut dhe psikologut.

Ambienteve te tjera nuk u ndryshon funksioni I tyre qe kane aktualisht.

Ne siperfaqen klasave qe nuk ka pllaka, te shtrohen teresisht te reja. Dyert parashikohet te zevendesohen me dyer te reja, duke ruajtur dimensionet dhe modelin e dyerve ekzistuese.



Te prishen dhe të ribehen suvatimet e mureve dhe tavaneve atje ku eshte e nevojshme dhe do të lyhet e gjithë godina.

Banjot ne tere katet do te rikonstruktohen dhe do trajtohen teresisht me tere elementet. Rëndesi e vecante do t' i kushtohet hidroizolimit.

Një ambient ne katin perdhe do të kthehet në Palester , do të shtrohet me parket.

Catia do të riparohet dhe do të perforcohet per eliminimin e uljes dhe do te behet zevendesimi i ulluqeve te demtuar.

Do të instalohet sistemi i ngrohjes qendrore dhe i furnizimit me ujë .

Fasadat e shkolles do të ruhen, por do behet rilyerja e fasades.

Do të ndërtohet fusha e voljebollit/basketbollit me nënshtresat perkatëse

Do të ndërtohet fusha e minifutbollit me nënshtresat perkatëse dhe bar artificial

Do të realizohet rrethimi me rrjet teli I veshur me plastike ngjyre jeshilepër sheshet sportive dhe paisjet perkatëse

Muri rrethues do të suvatohet dhe të vendosen kangjella, do të sistemohet oborri dhe do të vendosen stola, kende lojnash të pershtatshme per keto grup mosha.

**Ing. Alma Ristani**

**Ark. Bledar Dodaj**

**Ark. Sara Ristani**

**Ing. Zhuljeta Prifti**

